



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 190, datë 04.06.2020

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.90, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 135, pika 4 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, duke mbajtur parasysh kandidatët që kanë aplikuar brenda afatit të kandidimit (datë 13.05.2020) për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 90, datë 26.02.2020 dhe faktin se kandidatët janë në proces e sipër verifikimi të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin e tij nr. 88 dhe nr. 89, datë 26.02.2020,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88 dhe nr.89, datë 26.02.2020, si dhe për kandidaten znj. {...}, e cila ka aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 88, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR